

KURUM INTERNATIONAL SH.A.

Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Përmbajtja

Faqe

Pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta:

Raporti i audituesit të pavarur	i-iii
Pasqyra individuale e pozicionit finanziar	1
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëperfshirëse	2
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra individuale e flukseve të mjeteve monetare	4
Shënimë mbi pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta	5 – 32

Raporti i Audituesit të Pavarur

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D, Shk. B
Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560
www.grantthornton.al

Për aksionarët dhe drejtimin e Kurum International Sh.a,

Opinion me Rezerve

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta bashkëngjitur të Kurum International Sh.a (këtu e më poshtë referuar “Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve të parasë për vitin e myllur në atë datë dhe një përbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe të tjera shënime shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të pëershruara në seksion e raportit tonë *Bazat për Opinionin me Rezervë*, pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mylllet në këtë datë, në përpunhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin me Rezervë

1. Pasqyra individuale e pozicionit financiar përfshin Aktive afatgjata materiale (shenimi 6) për vlerën 13,324,460 mijë lekë (2016 – 12,971,731 mijë lekë). Shoqëria nuk ka kryer një inventarizim dhe vlerësim per vlerën e rikuperueshme të këtyre aktiveve. Gjithashtu, Shoqëria nuk disponon dokumentacion të plotë mbështetës për blerjet e hershme të kategorive toka, ndërtesa dhe makineri të përfshira në aktivet afatgjata materiale. Nga procedurat alternative te kryera, ne nuk arritëm të merrnim sigurinë e mjaftueshme dhe të duhur mbi evidencën lidhur me vlerësimin dhe plotësinë e aktiveve afatgjata materiale. Rrjedhimisht, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim është i nevojshëm për aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2017.
2. Pasqyra individuale e pozicionit financiar përfshin Aktivet afatgjata jo-materiale (shenimi 7) në vlerën 1,737,437 mijë Lekë (2016: 2,432,652 mijë Lekë). Më 31 tetor 2013, Shoqëria ka përvitit HEC Ulëz Shkopet Sh.a. dhe HEC Bistrica 1 Bistrica 2 Sh.a, të cilat ishin blerë paraprakisht gjatë muajit maj 2013, si dhe ka njojur emrin e mirë prej 4,634,764 mijë Lekë. Shoqëria ka amortizuar emrin e mirë sipas metodës lineare duke aplikuar një normë vjetore prej 15%, gjë e cila nuk është në përpunhje me kërkuesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK 36) “Zhvlerësimi i Aktiveve”, i cili kërkon që emri i mirë i lindur nga kombinimi i biznesit të testohet çdo vit për zhvlerësimin dhe të mos amortizohet. Rrjedhimisht, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim është i nevojshëm për emrin e mirë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016.

3. Pasqyra individuale e pozicionit financiar përfshin të arkëtueshmet financiare në vlerën 14,377,428 mijë lekë (2016: 14,844,314 mijë lekë) të cilat përbëhen nga dëftesa të pagueshme nga Balmondere Business LP bazuar në kushtet e kontratës së firmosur më 22 dhjetor 2015. Gjatë vitit 2017 dhe 2016, Balmondere Business LP ka shlyer një pjesë të vlerës së papaguar duke e furnizuar Shoqërinë me lëndë të parë. Megjithatë, shlyerjet e pagesave nuk janë kryer sipas skedulit të pagesave të kontratës dhe gjatë vitit 2018 nuk ka patur arkëtime. Për më tepër, Shoqëria nuk ka kryer një ndarje të këtij aktivitë në të drejtë që priten të likuidohen në mjete monetare dhe të drejtë që priten të likuidohen me lëndë të parë. Megjithëse ekzistonin të dhëna objektive zhvlerësimi për këto teprica në datën e raportimit, Shoqëria nuk kreu çmuarje për zhvlerësim sipas kërkesave të SNK 39 "Instrumentat Financiarë - Njohja dhe Matja" dhe SNK 36 "Zhvlerësimi i Aktiveve". Gjithashtu, Shoqëria nuk ka kryer një vlerësim, mbi të drejtat që priten të likuidohen në mjete monetare, për kursin e fundvitit sipas kërkesave të SNK 21 'Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit'. Rrjedhimisht, në mungesë të evidencës së përshtatshme të auditimit përikuiperimin e të arkëtueshmeve financiare, ne nuk mund të përcaktojmë nëse kishte nevojë për rregullime të provizonit për zhvlerësim dhe përkthimit të kursit të këmbimit përikuarkëtueshmet financiare më 31 dhjetor 2017.
4. Pasqyra individuale e pozicionit financiar përfshin inventarin në vlerën 4,286,527 mijë lekë (2016: 2,441,016 mijë lekë). Ne nuk ishim kontraktuar si audituesit e Shoqërisë deri më 31 dhjetor 2017, dhe si rrjedhojë ne nuk kemi vëzhguar numërimin fizik të inventarit të Shoqërisë në fillim dhe në fund të vitit. Ne nuk mundëm të merrnim siguri nëpërmjet procedurave alternative në lidhje me sasinë dhe vlerat e mbartura të inventarit më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016. Rrjedhimisht, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim ishte i nevojshëm përiku inventarin më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016.
5. Pasqyra individuale e pozicionit financiar përfshin të drejta nga palët e lidhura në vlerën 372,183 mijë lekë (2016: 655,240 mijë lekë) të cilat përfshijnë të drejta ndaj Albanian Oil Refinery Sh.a (shënim 15, 31) në vlerën prej 162,201 mijë lekë. Kurum International Sh.a, aksionari i vetem i Albanian Oil Refinery ka pezulluar aktivitetin e kësaj të fundit. Megjithëse, ekzistonin të dhëna objektive zhvlerësimi për këto teprica në datën e raportimit, Shoqëria nuk ka njohur zhvlerësimin sipas kërkesave të SNK 39 – "Instrumentat Financiarë - Njohja dhe Matja". Rrjedhimisht, fitimi i vitit është mbivlerësuar me vlerën 162,201 mijë lekë dhe të drejta ndaj paleve të lidhura janë mbivlerësuar me të njëjtën vlerë më 31 dhjetor 2017.
6. Pasqyra e individuale e pozicionit financiar përmban llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera në vlerën 8,510,426 mijë lekë (2016 - 8,107,837 mijë leke). Janë identifikuar disa të arkëtueshme në vlerë 2,069,376 mijë lekë në vonesë përi më shumë se një vit, prej të cilave 614,307 mijë lekë vlerësohen nga drejtimi me propabilitet të ulët arkëtimi. Drejtimi nuk ka hartuar dhe zbatuar një politikë specifikë përikuadresuar nevojën për zhvlerësim të ketyre tepricave. Si rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje përikuadrecaktuar nëse ndonjë rregullim ishte i nevojshëm lidhur me provigjonin e llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2017.
7. Sikurse tregonet në shënimin 29, në shpenzime interesante nga huatë përikuvitin e myllur më 31 dhjetor 2017 janë përfshirë interesat e përllogaritura që i përkasin vitit të myllur më 31 dhjetor 2016 në vlerën prej 400,097,049 lekë, bazuar në Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 30 qershor 2016 "Përimiratimin e planit të riorganizimit". Nëse Shoqëria do të kishte përfshirë këto interesa në vitin 2016 dhe jo në vitin 2017, fitimi i vitit 2017 do të rritet me 400,097,049 lekë dhe humbja e vitit 2016 se bashku me huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2016 do të rriteshin me po të njëjtën vlerë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale për Qëllime të Veçanta*. Ne jemi të pavarrur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njojur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkosat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidencia e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Pasiguri Materiale Lidhur me Vlijimësinë e Biznesit

Ne tërheqim vëmendjen për Shënim '3.1 Parimi i Vlijimësisë' në pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta, ku përshkruhet se Shoqëria ka raportuar një humbje të akumuluar prej 4,267,613 mijë lekë më 31 dhjetor 2017 (2016: 4,572,159 mijë lekë). Për më tepër, siç prezantohet në shënimin 1 të pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta, bazuar në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë numër 6631, datë 30 qershor 2017, Shoqëria u bë pjesë e një plani riorganizimi 7-vjeçar, sipas të cilit u riskedulua dhe miratua plani i pagesave ndaj kreditorëve dhe operacionet e saj në të ardhmen e parashikueshme. Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë më anë të vendimit numër 10234 datë 11.12.2018 vendosi, miratimin dhe aprosimimin e veprimitarise së administratorit të Shoqërisë z. Servet Sakir Kurum, që nga momenti i emërimit të tij me Vendimin e Asamblese së Përgjithshme të datës 31.10.2017 për të vepruar në një mandat 3 (tre) vjecar. Statusi i Shoqërisë ishte ("Shoqëri në procedurë falimenti") u be ("Aktiv"). Drejtimi pranon se pasiguria mbetet mbi aftësinë e Shoqërisë për të përbushur nevojat e likuiditetit dhe për të shlyer borxhet e saj. Megjithatë, drejtimi pret që Shoqëria të ketë burime të përshtatshme për të siguruar mbështetjen e nevojshme financiare për të vazduhar operacionet e saj në të ardhmen e parashikueshme. Këto ngjarje ose kushte, së bashku me çështje të tjera, të përcaktuara në Shënimin 3.1, tregojnë se një pasiguri materiale ekziston, e cila mund të shkaktojë dyshim të rëndësishëm në aftësinë e Shoqërisë për të vazduhar në vijimësi. Opinion i ynuk është modifikuar për sa i përket kësaj çështje.

Çështje të Tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 u audituan nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion me rezervë lidhur me parimin e vijimësinë mbi ato pasqyra financiare më 31 maj 2017.

Përgjegjësitë e Drejimit dbe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale për Qëllime të Veçanta

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta që nuk përbajnjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazduhar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvèç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përvèç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësiti e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale për Qëllime të Veçanta

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale për qëllime të veçanta.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojme gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i mosbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretim, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrëthanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmérinë e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmënë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur te parimit kontabël të vijimësise nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojme që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Shoqëria të ndalojë së vazhduar në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojme me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rendësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Kledian Kodra, Fca
Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

22 shkurt 2019




Pasqyra e Individuale e Pozicionit Financiar

	Shënim	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivet			
Aktive afatgjata materiale	8	13,324,460,092	12,971,731,540
Aktive afatgjata jomateriale	9	1,737,437,306	2,432,651,846
Investime në shoqëri të kontrolluara	10	9,800,000	9,800,000
Të arkëtueshme financiare	11	14,377,427,705	14,844,314,300
Totali i aktiveve afatgjata		29,449,125,103	30,258,497,686
Garanci dhe parapagime	12	1,263,813,562	2,605,411,897
Inventarë	13	4,286,526,857	2,441,015,951
TVSH e arkëtueshme, neto	14	1,228,895,923	548,545,946
Të drejtë nga palët e lidhura, neto	15	372,183,033	655,239,750
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	16	8,510,425,816	8,107,837,274
Tatim mbi fitimin i parapaguar	30	624,936,587	624,946,587
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	17	109,683,716	372,100,797
Totali i aktiveve afatshkurtra		16,396,465,494	15,355,098,202
Totali i aktiveve		45,845,590,597	45,613,595,888
Kapitali			
Kapitali i paguar	18	6,864,800,000	6,864,800,000
Rezerva ligjore	18	236,832,376	236,832,376
Rezerva të tjera	18	2,332,441,009	2,332,441,009
Humbje të mbartura		(4,267,612,554)	(4,572,158,973)
Totali i kapitalit		5,166,460,831	4,861,914,412
Detyrimet			
Huatë afatgjata	19	25,821,153,741	20,956,541,077
Totali i detyrimeve afatgjata		25,821,153,741	20,956,541,077
Huatë afatshkurtra	19	3,159,551,588	8,801,383,865
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	20	11,470,312,906	10,864,471,834
Detyrime qiraje financiare	21	-	21,780,412
Dividend i pagueshmëm	22	66,065,035	66,065,035
Detyrime të tjera	23	162,046,495	41,439,253
Totali i detyrimeve afatshkurtra		14,857,976,024	19,795,140,399
Totali i detyrimeve		40,679,129,765	40,751,681,476
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		45,845,590,596	45,613,595,888

Pasqyra individuale e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 32, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta.

Pasqyrat financiare në faqet 1 deri në 32 janë miratuar nga drejtimi i Kurum International sh.a dhe u nënshkruan nga:

Servet Kurum
Administrator



Mirjeta Zotaj
Ekonomiste

Lindita Kikino
Administratore falimenti

Pasqyra individuale e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

	Shënim	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura	24	19,874,674,551	12,213,363,692
Të ardhura të tjera operative	25	169,067,595	144,091,375
Ndryshime në inventarë		599,366,296	(398,182,445)
Materiale bruto dhe të konsumueshme të përdorura	26	(15,175,742,913)	(8,879,541,329)
Fitimi bruto		5,467,365,529	3,079,731,293
Shpenzime personeli	27	(573,287,188)	(452,823,980)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	8,9	(1,795,279,806)	(1,977,654,303)
Shpenzime të tjera	28	(2,166,277,006)	(851,108,169)
Fitimi operativ		932,521,529	(201,855,159)
Shpenzime financiare, neto	29	(567,641,579)	(293,491,265)
Shpenzime financiare, neto		(567,641,579)	(293,491,265)
Fitimi para tatimit		364,879,950	(495,346,424)
Tatimi mbi fitimin	30	-	-
Fitimi neto për vitin		364,879,950	(495,346,424)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		364,879,950	(495,346,424)

Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 32, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta.

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital

Shënimë	Kapitali i paguar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Humbjet e akumuluara	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	6,864,800,000	236,832,376	2,332,441,009	(4,076,812,549)	5,357,260,836
Humbja e vittit	-	-	-	(495,346,424)	(495,346,424)
Total i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	(495,346,424)	(495,346,424)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	6,864,800,000	236,832,376	2,332,441,009	(4,572,158,973)	4,861,914,412
Korrigimi i gabimeve të periudhave të mëparshme	-	-	-	(60,333,531)	(60,333,531)
Fitimi i vittit	-	-	-	364,879,950	364,879,950
Total i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	364,879,950	364,879,950
Gjendja më 31 dhjetor 2017	6,864,800,000	236,832,376	2,332,441,009	(4,267,612,554)	5,166,460,831

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 32, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta.

Pasqyra Individuale e Flukseve monetare

	Shënim	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitimi/(humbja) para tatimit		364,879,950	(495,346,424)
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	8,9	1,795,279,806	1,977,654,303
Humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	16	64,927,330	(255,000)
Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		174,992	40,908
Shpenzime interesë	29	1,414,378,996	873,941,537
Humbje nga zhvlerësimi i inventarit		-	(2,071,000)
Korrigjime të gabimeve nga periudha të mëparshme		-	(60,333,531)
		3,639,641,074	2,293,630,793
<i>Ndryshime në:</i>			
Rënje në të arkëtueshme financiare		466,886,595	276,530,044
Rënje/(rritje) në garanci dhe parapagime		1,341,598,337	(905,639,034)
(Rritje)/rënje në inventarë		(1,845,510,906)	1,289,702,621
Rritje në TVSH-në e arkëtueshme		(680,349,977)	(4,412,703)
(Rënje)/ rritje në të drejtat nga palët e lidhura		283,056,717	(266,166,326)
Rritje në të arkëtueshme tregtare dhe të tjera		(282,942,143)	(4,979,618,039)
Rritje në të pagueshme tregtare		360,943,814	1,726,601,804
Rritje/(rënje) në të pagueshme të tjera		120,607,240	(128,597,615)
Flukset monetare neto nga/ (të përdorura në aktivitetet operative		3,403,930,751	(697,968,455)
Interes i paguar		(625,646,268)	(466,923,785)
Flukset monetare neto nga/ (të përdorura në aktivitetet operative		2,778,284,483	(1,164,892,240)
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese			
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	8	8,520,572	937,633
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	8	(1,461,489,383)	(16,451,580)
Investime		-	4,250,090
Flukset neto të parasë të përdorura në aktivitetet investuese		(1,452,968,811)	(11,263,857)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese			
Ripagimi neto i huave		(1,565,952,341)	1,583,659,329
Ripagimi i qirave financiare		(21,780,412)	(48,481,435)
Flukset neto të parasë të përdorura në aktivitetet financuese		(1,587,732,753)	1,535,177,894
Rënia neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to		(262,417,081)	359,021,797
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në 1 janar	17	372,100,797	13,079,000
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në 31 dhjetor	17	109,683,716	372,100,797

Pasqyra individuale e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 32, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta.

Shënimet për pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta

1. Informacion i përgjithshëm

Kurum International Sh.a. ("Shoqëria") u themelua nga Gjykata e Rrethit Tiranë me vendimin nr. 20268 më 11 nëntor 1988 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT K0272730T. Më 1 dhjetor 2006, Shoqëria ndryshoi statusin nga Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar në Shoqëri Aksionare. Më 31 tetor 2013, Shoqëria ka përvitur HEC Ulëz Shkopet Sh.a. dhe HEC Bistrica 1 Bistrica 2 Sh.a, të cilat ishin blerë paraprakisht gjatë muajit maj 2013. Shoqëria zotërohet nga Znj. Selin Kurum dhe Znj. Melis Kurum me pjesëmarrje 50% secila. Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është prodhimi dhe shitja e hekurit të përdorur për ndërtim, prodhimi dhe shitja e energjisë, etj. Shoqëria është e lincensuar nga Enti Rregulator i Energjisë ("ERE") për prodhimin dhe shitjen e energjisë.

Për shkak të paaftësisë paguese të Shoqërisë të parashikuar në të ardhmen e afërt, më datë 16 Mars 2016 Shoqëria hapi çështjen me nr. 6631 në Gjykatën e Rrethit Tiranë për nisjen e procedurave të falimentimit, caktimin e një administratori për falimentin dhe ruajtjen e vetë-administrimit. Administratori i falimentit u caktua Znj. Lindita Kikino.

Më 15 prill 2016, Gjykata aprovoi pretendimet e kreditorëve të paraqitura nga Znj. Kikino.

Më 30 qershor 2017, Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi mbi "Miratimin e Planit të Riorganizimit". Sipas planit, huatë e Shoqërisë ndaj kreditorëve të siguruar do të mbartin një normë interesit prej 5.3%, respektivisht për huatë ndaj International Financial Corporation ("IFC"), e tipit sindikatë (Bankës Kombëtare Tregtare ("BKT") dhe e Raiffesisen Bank), dhe 5.1% ndaj Black Sea Trade and Development Bank ("BSTD"). Norma e interesit për huatë ndaj kreditorëve të pasiguruar do të mbartë një normë prej 2%.

Bazuar në kërkesën e kreditorëve te siguruar, norma e interesit i pagueshem do të jetë 2% në vitin 2017, 2.5% në 2018, 3% në 2019 dhe 3.5% nga viti 2020 deri në 2023.

Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë më anë të vendimit numër 10234, datë 11.12.2018, vendosi, miratimin dhe aprovimin e veprimtarisë së administratorit të Shoqërisë z. Servet Sakir Kurum, që nga momenti i emërimit te tij me Vendimin e Asamblee së Përgjithshme të datës 31.10.2017 për të vepruar në një mandat 3 (tre) vjecar. Statusi i shoqërisë ishte ("Shoqëri në procedurë falimenti") u bë ("Aktiv").

Shoqëria është e vendosur në Shqipëri. Adresa e zyrës së regjistruar është Njësia Administrative nr. 5, Rruga "Ibrahim Rugova", Pallati nr. 14, "Green Park" Apartamenti nr. 39, Kati i 6-ë, Tiranë, Shqipëri.

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta (ketu e më poshtë referuar “pasqyrat financiare”) janë përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit finansiar dhe legjislacionit në Shqipëri. Kuadri kontabel i aplikuar është i bazuar në politikat kontabёl të listuara në shënimin 4, të cilat janë të bazuara në kërkesat për raportim sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), përvèç mungesës së konsolidimit të Pasqyrave financiare të shoqërise të kontrolluara, të cilat janë Kurum Industrial Gases Sh.a, Albanian Oil Refinary sh.a, Durres Logistic Center sh.a. Më poshtë paraqiten politikat kontabel kryesore të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta.

Pasqyrat financiare bashkëngjitur janë të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) me përashtimin e konsolidimit, si shprehur më lart.

Detaje për politikat kontabёl të Shoqërisë, janë përfshirë në Shënimin 4.

2.2 Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lekë, e cila është monedha funksionale dhe prezantuese e Shoqërisë.

3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare sipas SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë vlerësim, gjykime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë prej këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

3.1 Vlerësimi i drejtimit për vijimësinë e aktivitetit të Shoqërisë

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur duke u bazuar në parimin e vijimësisë.

Shoqëria ka raportuar një humbje të akumuluar prej 4,267,612,554 Lekë më 31 dhjetor 2017 (2016: 4,572,158,973 Lekë

Sic prezantohet në shënimin nr. 1 të pasqyrave financiare, bazuar në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 6631, datë 30 qershor 2017, Shoqëria u bë pjesë e një plani riorganizimi 7-vjeçar, sipas të cilit u riskedulua dhe miratua plani i pagesave ndaj kreditorëve.

Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë më anë të vendimit numër 10234 datë 11.12.2018 vendosi, miratimin dhe aprovin e veprimtarise se administratorit të Shoqërisë z. Servet Sakir Kurum, që nga momenti i emërimit te tij me Vendimin e Asamblese së Përgjithshme të datës 31.10.2017 për të vepruar në një mandat 3 (tre) vjecar. Statusi i shoqërisë ishte (“Shoqëri në procedurë falimenti”) u be (“Aktiv”).

3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

3.1 Vlerësimi i drejimit për vijimësinë e aktivitetit të Shoqërisë (vazhdim)

Shoqeria, gjate vitit 2018 ka vijuar aktivitetin e saj në të gjithë sektoret e prodhimit, përfshire prodhimin e prokateve të celikut në fabriken e celikut, prodhimin e shufrave te celikut ne fabriken e petezimit, prodhimin e gelqeres ne fabriken e gelqeres, si dhe prodhimin e energjisë elektrike ne 4 HEC-et në pronësi të saj.

Me specifisht, gjate vitit të mbyllur 2018, sipas drejimit Shoqëria arriti rezultatet si vijon (të pauditura):

- Të prodhoje rreth 403,581 ton prokate celiku,
- Të prodhoje rreth 378,482 ton shufra celiku,
- Të shese 374,151 ton shufra celiku kundrejt 350,000 ton te buxhetuar
- Të prodhojë rreth 380 milione KW, nga te cilat rreth 228 milione KW janë destinuar per shitje dhe pjesa tjeter per përdorim ne fabriken e Elbasanit; dhe
- Të arrije ne xhiro vjetore ne nivelet e 210 milione Euro (të paudituar).

Gjithashtu, gjate vitit 2018, Shoqeria vijoi me planin e miratuar te Ristrukturimit, duke permbushur kushtet e planit, ne zbatim te Vendimit te Gjykates date 30.6.2017. Gjate ketij viti janë paguar kreditoret sipas parashikimeve ne plan, duke filluar edhe pagesat e principaleve per te dyja grupet e kreditoreve, qofte per kreditoret e siguruar, ashtu dhe per ato te pasiguruar. Sipas vlerësimeve te bera, ne total janë shlyer rreth 13 milione Euro ne principale dhe rreth 3.5 milione Euro interesa ndaj kreditoreve.

Sipas drejimit, gjate vitit 2018 janë implementuar investime kapitale (CAPEX) per te mundesuar rritjen e rendimentit ne prodhim dhe optimizimin e kostove në terësi.

Nderkohe, gjate vitit 2019 Shoqëria parashikon:

- Të rrisë volumin e prodhimit te celikut ne 400,000 ton shufra celiku;
- Të rrisë volumin e shitjes ne 400,000 ton shufra celiku;
- Të përfundoje planin e investimit ne Fabriken e Petezimit dhe Celikut; dhe
- Të arrije te gjeneroje shitje mbi nivelin e 220 milione Euro.

Drejtimi pranon se pasiguria mbetet mbi aftësinë e Shoqërisë për të përmbushur nevojat e saj të likuiditetit për të shlyer borxhet e saj. Megjithatë, drejtimi pret që Shoqëria të ketë burime të përshtatshme për të siguruar mbështetjen e nevojshme financiare për Shoqërinë për të vazhduar operacionet e saj në të ardhmen e parashikueshme. Shoqëria nuk ka ndërmend të likuidojë ose të ndërpresë veprimtarinë e saj në të ardhmen e parashikueshme. Drejtimi pret që Shoqëria të jetë fitimprurëse në të ardhmen dhe aftësia e saj për të vazhduar aktivitetin nuk do të dëmtohet.

3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

3.2 Matja e vlerës së drejtë

Një numër politikash kontabël dhe shënimesh shpjeguese të Shoqërisë kërkojnë matje sipas vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë që nuk shiten në një treg aktiv përcaktohen nga teknikat e vlerësimit. Shoqëria përdor gjykimin për të zgjedhur një numër te ndryshëm metodash dhe bën supozime të cilat bazohen kryesisht në kushtet e tregut në çdo datë raportimi. Shoqëria përdor analizën e skontuar të flukseve të parasë për aktivet dhe detyrimet financiare që nuk shiten në tregjet aktive. Kur një aktiv ose detyrim matet me vlerën e drejtë, Shoqëria përdor të dhëna tregu të vëzhgueshme për sa është e mundur.

Vlerat e drejta janë të kategorizuara në nivele të ndryshme hierarkie në bazë të dhënavë të përdorura në teknikat e vlerësimit si më poshtë:

Niveli 1: çmimi i kuotuar (i pa rregulluar) në tregjet aktive për aktivë ose detyrime të njëjtë apo identike.

Niveli 2: të dhëna të tjera përveç çmimit të kuotuar të përfshirë ne Nivelin 1 të cilat janë të vëzhgueshme, drejtpërdrejt (p.sh. çmimi) ose indirekt (p.sh. ato që derivojnë nga çmimi) për aktivin ose detyrimin.

Niveli 3: të dhëna për aktivin ose detyrimin të cilat nuk janë të bazuara në të dhëna tregu të vëzhgueshme (të dhëna jo të vëzhgueshme).

Nëse të dhënat e përdorura për të matur vlerën e drejtë të një aktivit ose detyrimi janë në nivele të ndryshme hierarkie, atëherë matja e vlerës së drejtë kategorizohet në tërësinë e saj në nivelin më të ulët hierarkik ku përfshihen të dhënat kryesore që përdoren për matjen e vlerës së drejtë.

Shoqëria i njeh transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

4. Politika të rëndësishme kontabël

Shoqëria ka aplikuar në mënyrë të qëndrueshme politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

Vlera të caktuara krahasuese në pasqyrën e pozicionit finanziar dhe atë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirese janë riklasifikuar ose paraqitur si rezultat i ndonjë ndryshimi në riklasifikim për të reflektoar një efekt më të mirë.

4.1 Transaksione në monedhë të huaj

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten në LEK, që është monedha e mjedisit ekonomik në të cilin operon njësia ekonomike.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, transaksionet në monedha të ndryshme nga monedha funksionale e njësisë ekonomike (monedhat e huaja) njihen me kursin e këmbimit në datën e transaksioneve. Në fund të se cilës periudhë raportuese, artikujt monetarë të shprehur në monedha të huaja përkthehen me normat e asaj date. Zërat jo-monetarë që maten në aspektin e kostos historike në një monedhë të huaj, nuk përkthehen përsëri.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.1 Transaksione në monedhë të huaj (vazhdim)

Diferencat e këmbimit njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato paraqiten.

Normat e aplikueshme të këmbimit në Lekë të përdorura për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare për monedhat EUR, USD, CHF më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	Kursi në datën e raportimit	
	2017	2016
EUR/Lek	132.95	135.23
USD/Lek	111.10	128.17
CHF/Lek	113.94	126.05

4.2 Inventarët

Inventari matet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e kostos mesatare dhe përfshin shpenzimet për blerjen e inventarëve, kostot e prodhimit apo të transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë sjelljes së tyre në vendndodhjen dhe kushtet ekzistuese.

Vlera neto e realizueshme është vlerësuar me çmimin e shitjes gjatë aktivitetit normal minus kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

4.3 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jo-materiale të blera nga Shoqëria janë paraqitur me kosto të pakësuar me amortizimin dhe humbjet e akumuluara të rënies në vlerë. Shpenzimet vijuese të aktiveve afatgjata të patrupëzuara kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivet specifike me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen në momentin që ndodhin.

Amortizimi njihet ne pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë lineare mbështetur ne jetëgjatësinë e vlerësuar të aktiveve nga data e vënisë në punë me një normë amortizimi prej 15%.

4.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Zëri i aktiveve afatgjata materiale paraqitet në pasqyrën e pozicionit finanziar me kosto, minus zhvlerësimin e akumuluar dhe rënien në vlerë, nesë ka të tillë.

Kostoja përfshin tarifat profesionale dhe, për aktivet kualifikuese, kostot e huamarrjes kapitalizuar në përputhje me politikën kontabël të Shoqërisë. Aktive të tilla klasifikohen në kategoritë e përshtatshme të tokave, makinerive dhe pajisjeve kur të janë përfunduar dhe gati për përdorim. Zhvlerësimi i këtyre aktiveve, në të njëjtën bazë si aktivet e tjera të pasurive të paluajtshme, fillon kur aktivet janë të gatshme për përdorim.

Kostoja e zëvendësimit të objekteve të pronës ose pajisjeve njihet me vlerën e mbetur të objektit, nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të përfshira brenda objektit do të qarkullojë në Shoqëri, kostot e tij mund të maten në mënyrë të besueshme dhe amortizohen sipas trethanave. Kur ngrihet një kontroll, kostoja e tij njihet me vlerën e mbetur të objektit si material zëvendësues nëse përmbyshen kriteret e njohjes. Kostot ditore të riparimit dhe mirëmbajtjes së pronës, impianteve dhe pajisjeve njihen si fitime ose humbje në momentin që ndodhin.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Kostot vijuese

Kosto vijuese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kapitalizohen nëse pritet që Shoqëria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga këto shpenzime.

Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet për të anuluar shumat e rivlerësuara të aktiveve afatgjata materiale duke i zbritur vlerën e mbetur sipas metodës së vlerës së mbetur të amortizimit dhe duke përdorur normat fiskale sipas Ligjit Shqiptar të tatimit mbi fitimin, dhe njihet në fitim ose humbje.

Ndërtesa	5%
Makineri	5% deri në 20%
Mjete transporti	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	20%
Kompjutera	25%

Toka dhe ndërtimi në proces nuk amortizohen. Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

4.5 Instrumentet financiare

Aktivet financiare joderivativë

Shoqëria fillimi si njeh llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera, dhe depozitat në datën që ato krijohen. Të gjithë aktivet e tjera financiare njihen fillimi si njihen fillimi si datën e tregtimit, kur Shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parashë së aktivit financiar ose kur Shoqëria transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parashë nga aktivit financiar në një transaksion në të cilin gjithë rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar transferohen. Çdo interes në aktiv financiar të transferuara që krijohet apo mbahet nga Shoqëria, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fiksë apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuara në një treg aktiv. Aktive të tillë njihen fillimi si vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë mjetet monetare gjendje si dhe depozitat me afat maturimi jo më të madh se tre muaj.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.5 Instrumentet financiarë

Detyrimet financiare joderivative

Shoqëria fillimisht i njeh detyrimet financiare në datën e tregtimit, kur Shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e tij kontraktuale shlyhen ose anulohen apo përfundojnë.

Aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financier atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Detyrimet financiare joderivative të Shoqërisë janë si vijon: hua dhe llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera.

Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare këto të pagueshmet tregtare dhe të tjera dhe huatë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç huave me norma interesë më të ulëta së normat e tregut, të cilat maten me vlerën e drejtë, ndryshimet e së cilës njihen në pasqyrën e të ardhurave ose shpenzimeve.

4.6 Provigionet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që flukse dalëse të përfitimeve ekonomike do të përdoren për shlyerjen e detyrimit.

Shuma e njohur si provigjon është vlerësimi më i mirë i shumës që kerkohet për të shlyer detyrimin aktual në fund të periudhës raportuese, duke marrë parasysh rreziqet dhe pasiguritë rreth detyrimit. Kur një provizion matet duke përdorur flukset monetare të vlerësuara për të shlyer detyrimin aktual, vlera kontabël e saj është vlera aktuale e atyre flukseve (kur efekti i vlerës në kohë të parastë është material).

Kur disa ose të gjitha përfitimet ekonomike të kerkuara për të shlyer një provizion priten të mbulohen nga një palë e tretë, një arkëtim njihet si një aktiv, nëse është praktikisht e sigurtë se rimbursimi do të merret dhe shuma e arkëtueshme mund të matet me besueshmëri.

4.7 Kapitali aksionar dhe dividendët

Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Dividendët

Shpërndarja e dividendëve për aksionarin e Shoqërisë njihet në pasqyrat financiare të Shoqërisë si detyrim në periudhën në të cilën janë aprovuar nga aksionari i Shoqërisë.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.8 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësimin e tyre. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të pritura të parasë skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe treziqet specifike për aktivin. Me qëllim që të testohet zhvlerësimi, aktivet që nuk mund të testohen individualisht grupohen bashkë në grupin më të vogël të aktiveve që gjenerojnë flukse hyrëse të parave nga përdorimi i vazhdueshëm i aktiveve që janë kryesish të pavarura nga flukset hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të tjera të aktiveve (njësia e gjenerimit të parasë ose 'NGJP').

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e NGJP-së së tij tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me NGJP-të shpërndahen duke pakësuar vlerat kontabël të aktiveve në njësi (Grupi i njësive) në mënyrë përpjesëtimore.

Humbjet nga zhvlerësimi vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues që humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm deri në mësën që vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar pasi të zbritej amortizimi, nëse nuk do të ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

4.8 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv finanziar i mbajtur jo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidence objektive që ai është zhvlerësuar. Një aktiv finanziar zhvlerësohet nëse të dhëna objektive tregojnë se ka ndodhur një ngjarje e cila ka sjellë humbje pas njohjes fillestare te aktivit, dhe kjo ngjarje ka pasur efekt negativ mbi flukset monetare të parashikuara nga ai aktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme.

Evidencia objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë mospagimin apo vonesat në pagesë nga debitorët, ristrukturimin e një shumë për t'u paguar Shoqërise me terma të cilat Shoqëria nuk do t'i pranonë në një rast të kundërt si dhe treguesit që një debitor ose emetues do të shpallë falimentimin.

Shoqëria konsideron evidencën e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme në nivel individual dhe kolektiv të aktiveve. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme individualisht të rëndësishme vlerësohen në mënyrë specifike për zhvlerësim. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme individualisht të rëndësishme që nuk zhvlerësohen në mënyrë individuale, vlerësohen në mënyrë kolektive për ndonjë zhvlerësim që ka ndodhur, por që nuk është identifikuar ende. Llogaritë e arkëtueshme individualisht jo të rëndësishme vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim duke grupuar bashkë llogaritë e arkëtueshme me karakteristika të ngjashme reziku.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.8 Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Në përcaktimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqëria përdor tendencën historike të probabilitetit të mospagimit, kohën e arkëtitit dhe shumën e humbjes së shkaktuar, korriguar sipas gjykimit të drejtuesve nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kredidhënies janë të tilla që humbjet aktuale ka të ngjarë të jenë më të mëdha ose më të vogla se sa sugjerohet nga tendencat historike.

Një humbje nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferençë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme monetare të ardhshme skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivitit. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe paraqiten në një llogari provizioni që pakëson llogaritë e arkëtueshme. Kur një ngjarje e mëvonshme sjell zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, ky zvogëlim rimerret në fitim humbje.

4.9 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme. Të ardhurat zvogëlohen për kthimin e llogaritur të konsumatorëve, zbritjet dhe pagesat e tjera të ngjashme.

Shitia e hekurit për ndërtim

Të ardhurat nga shitja e hekurit për ndërtim njihen në fitim ose humbje në varësi të sasisë faktike të shitur e cila matet në pikën e dorëzimit.

Shitia e energjisë

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike njihet bazuar në sasinë aktuale të energjisë në rrjetin e transmisionit, i matur në pikën e dorëzimit dhe duke zbritur humbjet nga transmetimi.

4.10 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen mbi bazë neto.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi kreditë dhe njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.11 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin e periudhës dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në fitim ose humbje përvèç rasteve kur lidhen me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi mbi fitimin e periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose arkëtar mbi të ardhurat e tatushme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet, duke marrë në konsideratë diferençat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi, dhe që nuk ndikon fitimin ose humbjen kontabël dhe as atë tatimore.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën Shoqëria pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose shlyer vlerën kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.11 Tatimi mbi fitimin

Tatimi i shtyrrë llogaritet me normat tativore që pritet të jenë të zbatueshme ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi në datën e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tativore netohen mes tyre nëse ekziston një e drejtë e rregulluar me ligj për të netuar detyrimet dhe aktivet tativore të periudhës, dhe kur ato lidhen me tative që vendosen nga i njëjtë autoritet tativor mbi të njëtin subjekt tativor, ose mbi subjekte të ndryshme tativore, por që kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet tativore të periudhës në baza neto, ose aktivet dhe pasivet e tyre tativore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Taksat e tjera që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve nga Shoqëria njihen në të njëjtën kohë si detyrimi për të paguar dividendin e lidhur me të.

Një aktiv tativor i shtyrrë për humbje tativore të papërdorura, kreditime tativore dhe diferenca të zbritshme të përkohshme njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme të tatushme kundrejt të cilave diferençat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet tativore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tativor në lidhje me to të realizohet.

4.12 Qiratë

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënesi klasifikohen si qira operative. Pagesat e qirave operative (pasi zbriten stimujt e pranuar nga qiradhënesi) njihen me metodën lineare në fitim ose humbje përgjatë periudhës së qirasë.

4.13 Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi Shoqëria është e detyruar të paguajë kontributet fiksë për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës njihen si shpenzim kur Shoqëria është e angazhuar dukshëm, pa mundësi reale tërheqjeje dhe kur Shoqëria njeh kosto ristrukturimi. Nëse përfitimet nuk pritet të zgjidhen tërësisht brenda 12 muajve nga data e raportimit, atëherë ato skontohen.

4.14 Ndryshimet në politikat kontabël

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar.

Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në securinë e Shoqërisë.

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar.

Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në securinë e Shoqërisë.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.14 Ndryshimet në politikat kontabël

4.14.1 Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017

Shoqëria nuk ka adoptuar standarde të reja apo ndryshime që kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet e Shoqërisë apo pozicionin financiar.

Standardet dhe ndryshimet që janë efektive për herë të parë në vitin 2017 (për subjektet që mbyllen më 31 dhjetor 2017) dhe mund të janë të zbatueshme për Shoqërinë janë:

Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2014-2016 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) Ndryshimet në SNK 7 'Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare'

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto pasqyra financiare dhe për këtë arsyen nuk është bërë dhënia e informacioneve shpjeguese.

4.14.2 Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, si dhe ndryshime të standardeve ekzistuese, që ende nuk janë efektive dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria, janë publikuar nga BSNK. Informacion mbi ato standarde që pritet të janë të rëndësishme për pasqyrat financiare të Shoqërisë është dhënë më poshtë. Drejtimi pret që të gjitha standardet relevante do të miratohen në politikat kontabël të Shoqërisë për periudhën e parë që fillon pas hyrjes në fuqi të shpalljes. Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet të cilat nuk janë miratuar apo të shënuara më poshtë nuk pritet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SNRF "Instrumentet Financiare" 9

Standardi i ri për instrumentet financiare (SNRF 9) paraqet ndryshime të mëdha në udhezimet e SNK 39 mbi klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe prezanton një model të ri "humbje krediti të pritshme" për zhvlerësimin e aktiveve financiare. SNRF 9 gjithashtu ofron udhëzime të reja për zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Drejtimi ka filluar të vlerësojë ndikimin e SNRF 9, por nuk është ende në gjendje për të dhënë informacion sasior. Në këtë fazë fushat kryesore të ndikimit të pritshëm janë si më poshtë:

- klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare të Shoqërisë do të duhet të shqyrtohen në bazë të kritereve të reja të cilat konsiderojnë flukset monetare kontraktuale të aktiveve dhe modelin e biznesit në të cilën ato janë administruar.
- një zhvlerësim i pritshëm me bazë humbje krediti do të duhet të njihet në të arkëtueshmet tregtarë të Shoqërisë, nëse nuk klasifikohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me kriteret e reja.

Ndryshimet në vlerën e drejtë do të paraqitet në fitim ose humbje, përvç rasteve kur Shoqëria bën një përcaktim të pakthyeshëm për të paraqitur ato në të ardhura të tjera përbledhëse.

4.14 Ndryshimet në politikat kontabël (vazhdim)

4.14.2 Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria (vazhdim)

SNRF 9 do të hyjë në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018. Shoqëria nuk ka ende kryer një vlerësim mbi impaktin për provigjonin mbi aktivet financiare, i cili sipas kërkesave te SNRF 9, duhet të përllogaritet sipas modelit te humbjeve te pritshme të ardhshme.

SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të ardhurave, duke zëvendësuar SNK 18 'Të ardhurat', 'SNK 11 Kontratat e ndërtimit', dhe disa Interpretime të lidhura me të ardhurat. Standardi i ri krijon një model njohjeje me bazë kontrolli të ardhurave dhe jep udhëzime shtesë në shumë fusha që nuk mbulohen në mënyrë të detajuar nga SNRF-ve ekzistuese, duke përfshirë mënyrën për njohjen e marrëveshjeve me detyrime të shumta të performancës, çmime të ndryshueshme, të drejtat e rimbursimit të konsumatorit, furnizuesi opsione e riblerjes nga furnizuesit, dhe kompleksitete të tjera të zakonshme.

Drejtimi ka filluar të vlerësojë ndikimin e Standardit të ri.

SNRF 15 hyn në fuqi në periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018. Shoqëria vlerëson se impakti nga IFRS 15 do të jetë i parëndësishem për shkak të natyres se aktiviteteve të saj.

SNRF 16 "Qiratë"

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretimet përkatëse. Kjo kompletion projektin e gjatë e BSNK-së për të rishikuar të kontabilitetin e qirave. Qiratë do të regjistrohen në pasqyrën e pozicionit finanziar në formën e një të drejtë përdorimi të një aktivi dhe të një detyrimi qiraje.

SNRF 16 hyn në fuqi në periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2019. Drejtimi është ende duke vlerësuar ndikimin e plotë të Standardit dhe për këtë arsy nuk është në gjendje të japë informacion sasior.

Megjithatë, për të përcaktuar ndikimin Shoqëria është në proces të:

- kryerjes së një rishikimi të plotë të të gjitha marrëveshjeve dhe për të vlerësuar nëse ndonjë kontratë shtesë tani do të bëhet një qira sipas përkufizimit të ri SNRF 16
- përcaktimit të dispozitave kalimtare që do të miratoj; aplikimin e plotë retrospektiv ose aplikimin e pjesshëm retrospektiv (që do të thotë informacioni krahasues nuk duhet të riparaqitet). Aplikimi i metodës së pjesshme jep gjithashtu një opsjon lehtësimi për rivlerësimin nëse kontratat ekzistuese janë, ose përbajnë, një qira, si edhe lehtësimi të tjera. Përcaktimi se cilët nga këto praktika do të miratohen është i rendësishëm pasi ato janë zgjedhje të pakthyeshme
- vlerësimi të informacioneve shpjeguese të saj aktuale për qiratë financiare dhe qirave operative pasi këto kanë të ngjarë të formojnë bazën e shumave që do të kapitalizohen dhe të bëhen të drejta përdorimi të aseteve
- përcaktimin se cilat thjeshtëzime opsonale kontabël do të zbatohen për portofolin e tyre të qirasë dhe nëse se do të përdoren përjashtime
- vlerësimi të sistemit të IT dhe nëse nevojitet një sistem të ri leasing. Kjo është duke u konsideruar në përputhje me zbatimin e SNRF 15 dhe SNRF 9 në mënyrë që Shoqëria vetëm t'i nënshtrohet një sërë ndryshimesh të sistemit njëkhohësisht
- vlerësimi për dhënien e informacioneve shpjeguese shtesë që do të nevojiten.

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpëra datave efektive të tyre.

5 Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut

5.1 Klasifikimet kontabël dhe vlera e drejtë

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to, llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera dhe llogarive të pagueshme konsiderohet të përafrojë vlerën e tyre kontabël pasi ato janë instrumente afatshkurtra që nuk mbartin interes.

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme financiare afat-gjata përcaktohet duke përdorur teknika të vlerësimit. Vlera e drejtë vlerësohet si vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme, të skontuara me normën e interesit të tregut në datën e raportimit.

5.2 Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria është e eksposuar ndaj rreziqeve të mëposhtme që rrjedhin nga instrumentet financiare:

- rreziku i kredisë;
- rreziku i tregut; dhe,
- rreziku likuiditetit.

Funksioni i administritimit të rrezikut brenda Shoqërisë kryhet në raport me trediqtet financiare (të kredisë, tregut, monedhës, likuiditetit dhe normës së interesit). Objektiivi kryesor i funksionit të administritimit të rrezikut financiar është të vendosë limite rreziku, dhe më tej të sigurohet se eksposizioni ndaj rreziqeve mbahet brenda këtyre limiteve. Funksionet e rrezikut operacional dhe ligjor janë parashikuar të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar trediqtet operacionale dhe ligjore.

Zhvillimet aktuale

Drejtimi i Shoqërise kryen monitorime 3-mujore mbi të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, flukseve monetare nga aktivitetet operacionale, si edhe të zhvillimeve në trediqtet ndërkontinentare. Bazuar në këtë, drejtimi analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe kërkon të zbatojë masat e duhura në lidhje me rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut (kryesisht çmimit të çelikut, hekurit dhe energjisë ndërsa normat e interesit përcaktohen nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë (shih shënimin 1)) dhe rrezikun e likuiditetit, duke limituar kështu efektet e mundshme negative të pasigurive të jashtme. Në këtë mënyrë, Shoqëria i përgjigjet sfidave të mijdisit të tregut duke ruajtur një kapital të qëndrueshëm.

5.2.1 Rreziku i kredisë

Shoqëria eksposozohet ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rreziku që njëra nga palët në një aktiv financiar të shkaktojë humbje financiare për palën tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi. Eksposimi kryesor i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë lind për shkak të arkëtueshmeve financiare, tregtare dhe të tjera.

5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut(vazhdim)

5.2 Administrimi i rrezikut finanziar (vazhdim)

Maksimumi i ekspozimit të Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë për kategorinë e aktiveve financiare dhe përkundërparti është si vijon:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktive financiare të arkëtueshme	14,377,427,705	14,844,314,300
Investime në Shoqëri të kontrolluara	9,800,000	9,800,000
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	372,183,033	655,239,750
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	8,510,425,816	8,107,837,274
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	109,683,716	372,100,797
Totali	23,379,520,270	23,989,292,121

Administrimi i rrezikut të kredisë

Shoqëria ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë në aktivitetet e tij të përditshme sepse mundet që kundërpartia e tij të dështojë në plotësimin e detyrimeve financiare.

Përqendrimi i rrezikut të kredisë

Shoqëria ekspozohet ndaj përqendrimit të rrezikut të kredisë. Shoqëria është e ekspozuar ndaj përqendrimit të rrezikut të kredisë. Më 31 dhjetor 2017, të arkëtueshmet financiare nga Balmondere Business LP përfaqësojnë 62% të totalit të ekspozimit maksimal ndaj rrezikut të kredisë (2016: 62%) dhe 2.78 herë (2016: 3.05) më të madh se kapitali i Shoqërisë. Palët kanë rënë dakord të paguajnë shumën e bazuar në një skedul pagesash me një normë interesë prej Libor 1 vjeçar në USD + 1% dhe maturitet deri në 30 nëntor 2020.

Zhvlerësimi

Lëvizjet në fondin e zhvlerësimit në lidhje me të arkëtueshme tregtare gjatë vitit janë si më poshtë:

	2017	2016
Gjendja më 1 janar	19,191,937	19,447,000
Anullimi i zhvlerësimit	-	(255,063)
Humbjet nga zhvlerësimi:	64,927,330	-
Gjendja më 31 dhjetor	84,119,267	19,191,937

Politika e fshirjes

Shoqëria fshin balancat e të arkëtueshmeve (dhe çdo fond lidhur me humbje nga zhvlerësimi) kur drejtimi vendos se të arkëtueshmet janë të pambledhshme. Ky vendim arrihet pasi konsiderohen informacione të tillë si masat domethënëse që janë ndërmarrë për rikuperimin e shumës, dhe se nuk ka mundësi të tjera për mbledhjen e balancave të papaguara.

Rreziku i tregut është rreziku nga humbja që rezulton prej ndryshimeve në çmimet e tregut të brendshëm (çmimi për shitjen e energjisë), kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilët ekspozohet Shoqëria në një moment të caktuar ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritshmërvë për çmimet e ardhshme ose ndryshimet në normat e tregut dhe përbërjen e aktiveve fizike dhe portofolit të kontratave të Shoqërisë.

5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)

5.2 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.2.3 Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria kryen transaksione në valutë të huaj dhe rrjedhimisht lindin ekspozime ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Ekspozimet e kursit të këmbimit menaxhohen sipas parametrave të miratuar të politikave duke përdorur kontratat e ardhshme të këmbimit valutor. Tabela e mëposhtme përfshin vetëm aktivet dhe detyrimet monetare dhe përbledh ekspozimin e Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit në datën e raportimit:

Monedha	Aktivet financiare monetare	Detyrime financiare monetare	31 dhjetor 2017 Pozicioni neto
Lek	5,709,963,616	(4,307,730,414)	1,402,233,202
EUR	1,814,745,745	(32,504,835,465)	(30,690,089,720)
USD	15,814,915,415	(3,704,517,391)	12,110,398,024
CHF	39,895,494	-	39,895,494
Totali	23,379,520,270	(40,517,083,270)	(17,137,563,000)

Monedha	Aktivet financiare monetare	Detyrime financiare monetare	31 dhjetor 2016 Pozicioni neto
Lek	5,868,068,895	(5,492,281,467)	375,787,427
EUR	1,624,976,115	(30,490,502,573)	(28,865,526,457)
USD	16,486,438,224	(4,727,458,183)	11,758,980,041
CHF	8,887	-	8,887
Totali	23,979,492,120	(40,710,242,223)	(16,730,750,102)

Administrimi i rrezikut të kurseve të këmbimit plotësohet përmes monitorimit të ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë ndaj skenarëve të ndryshëm standarde dhe jo standarde të kurseve të këmbimit. Skenarët standardë që konsiderohen në mënyrë të rregullt përfshijnë një rritje ose rënie paralele në kurset e këmbimit prej 100 pikësh bazë (pb).

Një analizë e ndjeshmërisë së Shoqërisë ndaj një rritjeje ose rënieje në vlerën e LEK-ut përkundrejt monedhave të huaja (duke supozuar se nuk ka lëvizje asimetrike dhe një pozicion financier të qëndrueshëm) është si vijon:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	100 pb	100 pb	100 pb	100 pb
Efekti i parashikuar				
fitim/(humbje)	rritje	ulje	rritje	ulje
EUR	(306,900,897)	306,900,897	(288,655,265)	288,655,265
USD	121,103,980	(121,103,980)	117,589,800	(117,589,800)
CHF	398,955	(398,955)	89	(89)

5.2.4 Risku i normës së interesit

Në rrjedhën normale të biznesit Shoqëria merr hua për të financuar operacionet e tij. Nisur nga Vendimi i Gjykatës së datës 30 qershor 2017 mbi “Aprovimi e Planit të Riorganizimit”, më datë 31 dhjetor 2017 Shoqëria ka hua të cilat kanë norma interesë prej 2% për kreditorët e pasiguruar dhe 5.1 %-5.3% për kreditorët e siguruar.

5 Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)

5.2 Administrimi i rrezikut finansiar (vazhdim)

5.2.5 Rreziku i çmimeve në tregje të tjera- çmimet e energjisë dhe hekurit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të çmimit të hekurit dhe të energjisë elektrike.

Rreziku i çmimit të hekurit dhe energjisë elektrike është rreziku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme të parasë do të jenë të varur nga ndryshimi i çmimit të hekurit dhe çelikut. Çmimet e mallrave nuk ndikohen vetëm nga marrëdhëniet midis Dollarit Amerikan dhe Lek-ut, por gjithashtu si rezultat i ngjarjeve ekonomike që ndikojnë në nivelin e kërkesës dhe ofertës globale.

Analiza e ndjeshmërisë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017, një rritje/(zvogëlim) me 10% e çmimit të hekurit, kur të gjithë variablat e tjerë mbahen të pandryshuar, do të rriste/(zvogëlonë) të ardhurat nga shitja e produkteve të gatshëm me 1,780,161,360 Lek (2016: 973,189,093 Lek).

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017, një rritje/(zvogëlim) me 10% e çmimit të energjisë, kur të gjithë variablat e tjerë mbahen të pandryshuar, do të rriste/(zvogëlonë) të ardhurat nga shitja e energjisë me 100.476.897 Lek (2016: 144.449.234 Lek).

5.2.6 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. Shoqëria është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorimin e burimeve të veta të parase kryesishët për të paguar shpenzimet operative që ndodhin në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Tabela e mëposhtme tregon detyrimet sipas maturimit kontraktual të mbetur në datën e raportimit. Shumat e paraqitura në tabelën e maturimit janë flukse të kontraktuara të skontuara të parase. Kur shuma e pagueshme nuk është fikse, shuma që paraqitet është përcaktuar duke iu referuar kushteve që kanë ekzistuar në datën e raportimit. Pagesat në monedhë të huaj janë konvertuar me kursin ditor të këmbimit në datën e raportimit.

	Deri në 1 vit	Mbi 5 vjet	Totali
2017			
Të pagueshme tregtare e të tjera	11,470,312,906	-	11,470,312,906
Huatë	3,159,551,588	25,821,153,741	28,980,705,329
Totali	14,629,864,494	25,821,153,741	40,451,018,235
	Deri në 1 vit	Mbi 5 vjet	Totali
Të pagueshme tregtare e te tjera	10,864,471,834	-	10,864,471,834
Huatë	8,801,383,865	20,956,541,077	29,757,924,942
Totali	19,665,855,699	20,956,541,077	40,622,396,776

5.3 Administrimi i kapitalit

Objektivat e Shoqërise në administrimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e Shoqërise për të vazhduar sipas parimit të vijmësë me qëllim të shlyerjen e kreditorëve të saj sipas vendimit më datë 30 qershori 2017 “Mbi Aprovimin e Planit të Riorganizimit”.

6. Informacioni krahasues

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë konsitente duke zbatuar politikat kontabёl të Shoqёrisё. Kur ёshtё e nevojshme, shifrat krahasuese riklasifikohen pёr qёllime tё konsistencёs në prezantim. Gjatё vitit 2017 Shoqёria ka kryer veprimin rregullues pёr shumën prej 60,333,531 lekё, pёr detyrimet e prapambetura pёr pёrdorim tё rezervёs ujore per H/C Bistrica nё periudhёn 2012-2016.

7. Raportimi i segmenteve

Një segment operues është pjesë përbërëse e Shoqërisë, që është i përfshirë në aktivitetet biznesi, nga të cilat mund të fitojë te ardhura dhe te kryeqë shpenzime, përsimrë eune te aruruar dhe shpenzimet që lidhen me veprimet me pjesët e tjera përbërësse të Shoqërisë. Rezultatet e segmenteve operuese rishlikohen në mënyrë të rregullt nga drejtimi për të marrë vendime trëth ndarjes së burimeve të seçlit segment për të vlerësuar performancën e tyre, dhe për të cilin duhet informacion i veçantë. Forma e përdorur prej Shoqërisë për raportim e segmentuar është bazuar në segmentimin sipas llojit të ardhurave dhe performancës. Performanca financiare sipas raportimit të segmenteve analizohet si më poshtë:

Për vitin emphyllur më 31 dhjetor 2017

8. Aktive afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Automjetë	Mobilje dhe pajisje Elektronike	Aktive në proces	Total
Më 1 janar 2016	565,261,362	7,991,044,959	13,636,655,765	179,765,888	153,756,731	37,349,976	22,563,834,681
Shëtesa	-	-	-	-	497,778	15,953,802	16,451,580
Pakësimë	-	-	(579,343)	(1,133,814)	(457,389)	-	(2,170,546)
Më 31 dhjetor 2016	565,261,362	7,991,044,959	13,636,076,422	178,632,074	153,797,120	53,303,778	22,578,115,715
Shëtesa	-	15,589,578	40,489,160	1,359,732	3,056,386	1,400,994,527	1,461,489,383
Pakësimë	-	-	(7,340,000)	(4,132,357)	-	-	(11,472,357)
Më 31 dhjetor 2017	565,261,362	8,006,634,537	13,669,225,582	175,859,449	156,853,506	1,454,298,305	24,028,132,741
Më 1 janar 2016	-	(1,239,291,254)	(6,878,061,814)	(113,116,313)	(94,667,034)	-	(8,325,136,415)
Amortizimi për vitin	-	(337,587,685)	(917,864,876)	(13,245,891)	(13,741,312)	-	(1,282,439,764)
Pakësimë	-	-	297,550	683,136	211,318	-	1,192,004
Më 31 dhjetor 2016	-	(1,576,878,939)	(7,795,629,140)	(125,679,068)	(108,197,028)	-	(9,606,384,175)
Amortizimi për vitin	-	(320,708,301)	(758,106,773)	(10,404,141)	(10,846,071)	-	(1,100,065,286)
Pakësimë	-	-	-	2,776,812	-	-	2,776,812
Më 31 dhjetor 2017	-	(1,897,587,240)	(8,553,735,913)	(133,306,397)	(119,043,099)	-	(10,703,672,649)
Vlera kontabëli neto							
Më 1 janar 2016	565,261,362	6,751,753,705	6,758,593,951	66,649,575	59,089,697	37,349,975	14,238,698,265
Më 31 dhjetor 2016	565,261,362	6,414,166,020	5,840,447,282	52,953,006	45,600,092	53,303,778	12,971,731,540
Më 31 dhjetor 2017	565,261,362	6,109,047,297	5,115,489,669	42,553,052	37,810,407	1,454,298,305	13,324,460,092

Më 31 dhjetor 2017, aktivet afatgjata materiale të Shqipërisë janë vendosur si kolateral përkredinë sindikatë midis IFC, BKTT, Raiffeisen dhe BSTID, dhe Albametal bazuar në kontraten nr. 968 dhe nr. 529, datë 02.02.2016.

9. Aktive jo-materiale

Më 31 dhjetor 2017, aktivet jo-materiale ishin 1,737,437,306 Lekë (2016: 2,432,651,846 Lekë). Blerja e HEC Ulzë Shkopet Sh.a. dhe HEC Bistrica 1, Bistrica 2 Sh.a. në vitin 2013 (shënim 1), rezultoi me emër të mirë prej 4,634,764,556 Lekë, i cili është amortizuar sipas politikave kontabël të përshkruara më lart. Shoqëria HEC Ulzë Shkopet ishte krijuar juridikisht më 31.08.2011. Aktiviteti kryesor përfshinte sigurimin e prodhimit dhe shitjen e energjisë elektrike. Në 31 tetor 2013, Shoqëria kishte 124 punonjës. Shoqëria HEC Bistrica 1 Bistrica 2 ishte krijuar juridikisht më 31.08.2011. Aktiviteti kryesor përfshinte prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike. Në 31 tetor 2013, Shoqëria kishte 70 punonjës.

Vlera e emrit të mirë HEC Ulzë Shkopet Sh.a

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Vlera bruto	3,552,592,905	3,552,592,905
Amortizim i akumuluar	(2,220,370,000)	(1,687,481,200)
Vlera neto e emrit të mirë	1,332,222,905	1,865,111,705

Vlera e emrit të mirë HEC Bistrica 1, Bistrica 2 Sh.a.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Vlera bruto	1,082,171,651	1,082,171,651
Amortizim i akumuluar	(676,957,250)	(514,631,510)
Vlera neto e emrit të mirë	405,214,401	567,540,141

10. Investime në shoqëri të kontrolluara

Aktualisht, Shoqëria zotëron 100 % të aksioneve në shoqérinë Kurum Industrial Gases Sh.a, 100% të aksioneve në shoqérinë Albania Oil Refinery sh.a dhe 52% të aksioneve në shoqérinë Durrës Logistic Center Sh.a. Shoqëria ka përdorur metoden e kostos për njohjen e këtyre investimeve.

Të dhënat mbi shoqëritë e kontrolluara tregohen si më poshtë:

Emri	Adresa	Aktiviteti Kryesor	Pjesëmarrja
Kurum Industrial Gases	Elbasan Bradashesh KOMB. ENERGIJ. FAB.OKSIGJENI	Shoqëri për prodhim dhe tregtim gazi	100%
Durres Logistic Center	Tirane Rruga Jul Variboba, nr 21/1	Shoqëri koncessionare e formës BOT	52%
Albanian Oil Refinery	Elbasan Bradashesh Ish-kombinati Metalurgjik, Komuna Bradashesh	Shoqëri koncessionare e formës ROT	100%

11. Të arkëtueshme financiare

Më 31 dhjetor 2017, të arkëtueshmet financiare janë në vlerën 14,377,427,705 (2016: 14,844,314,300) dhe përbëhen nga dëftesa të pagueshme nga Balmondere Business LP bazuar në kushtet e kontratës së firmosur më 22 dhjetor 2015. Këto të arkëtueshme financiare mbartin një normë interesit Libor 1 vjeçar në USD + 1% dhe maturim deri më 30 nëntor 2020.

Gjithashtu, sipas nenit 5 të kësaj kontrate palët kanë rënë dakord që gjatë periudhes së ristrukturimit, palët mund të angazhohen në marrëveshje të tjera tregtare, bazuar në kushtet e tregut dhe në tregun ku ato operojnë, dhe këto marreveshje mund të përfshijnë pagesat e kësteve duke i zbritur nga detyrime te tjera kontraktuale.

Gjatë vitit 2017 dhe 2016 Balmondere Business LP ka shlyer një pjesë të vlerës së arkëtueshme duke e furnizuar Shoqérinë me lëndë të parë.

12. Garanci dhe parapagime

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Parapagime për blerje inventarësh	928,820,840	2,483,276,246
Garancitë	311,701,430	91,010,014
Parapagime të tjera	23,291,292	31,125,637
Totali	1,263,813,562	2,605,411,897

Vlera me e madhe në parapagime për blerje inventarësh përbëhet nga parapagime për shoqërinë Ilyria Minerals Industry Sh.a në vlerën e 467,134,864,770 Lekë (2016: 464,864,770 Lekë) për blerjen e lëndës së parë.

Garancitë përbëhen nga llogaritë të bllokuara në favor të autoriteteve tatimore, doganave dhe gjykatave. Ne garancitë përfshihen edhe fondet e bllokuara pranë Bankës Kombëtare Tregëtare në vlerën 175,907,226 lekë (2016 -15,322,946 lekë). Më 31 dhjetor 2017, është shtuar garancia në vlerën 158,654,380 Lekë të cilat përfshijnë të drejta ndaj autoriteteve tatimore për fonde të vendosura nën sekuestro pranë Bankës Kombëtare Tregëtare për detyrime të tatimit mbi vleren e shtuar nga aktiviteti i shitblerjes së skrapit në vitin 2011. Shoqëria ka paditur sekuestron e fondeve në gjykaten e rrëthit Elbasan. Gjykata e rrëthit Elbasan me anë të vendimit numër 556 datë 19.07.2017 ka pranuar kërkësën e prokurorisë për bllokimin e këtyre fondeve. Vendimi i gjykates së apelit të Durresit numër 10-2017-2046 datë 9/29/2017 ka lënë në fuqi vendimin numër 556 datë 19.07.2017.

13. Inventarë

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Lëndë e parë dhe materiale të tjera	2,664,418,321	1,417,466,683
Produkt i gatshëm	1,622,108,536	1,023,549,268
Totali	4,286,526,857	2,441,015,951

Lënda e parë konsiston në skrap për përpunimin e hekurit, materiale ndihmëse, gëlqere, kimikate etj. Produkti i gatshëm konsiston në prokate e celikut në fabriken e celikut, shufrat e celikut në fabriken e petëzimit, dhe prodhimin e gëlqeres së fabriken e gëlqeres. Lënda e parë dhe produkti i gatshëm analizohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Lënda e pare		
Skrap	503,710,087	706,539,420
Materiale ndihmëse	1,947,384,562	631,463,064
Gur gelqeror	5,569,393	8,130,889
Të tjera	207,754,279	72,140,339
Total	2,664,418,321	1,418,273,712
Produkti i gatshëm		
Prokate	74,945,000	34,112,000
Shufrat e celikut	1,546,108,027	984,831,999
Gëlqere	1,055,509	3,798,240
Total	1,622,108,536	1,022,742,239
Total inventari	4,286,526,857	2,441,015,951

14. TVSH e arkëtueshme, neto

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
TVSH e arkëtueshme	1,228,895,923	552,808,631
TVSH e pagueshme	-	(4,262,685)
Totali	1,228,895,923	548,545,946

TVSH e rimbursueshme si rezultat i furnizimit me mallra dhe shërbime të deklaruara gjatë vitit 2017 është në vlerën 843,896,983 lekë. Vlera totale e TVSH-së në blerje e dekluaruar gjatë vitit 2017 është 3,764,813,661 lekë. Në datë 25 korrik 2018, Shoqëria ka marrë njoftimin nga autoritetet tatimore se është pranuar kërkesa për rimbursimin e TVSH-së në shumën prej 1,160,227 mijë lekë.

Gjithashtu, Shoqëria ka njojur TVSH të rimbursueshme vlerën e lidhur me vendimin të Gjykatës Administrative të Apelit Nr.67 datë 19.01.2017 sipas të cilës është lënë në fuqi Vendimi Nr. 7340 datë 15.12.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku shprehet për pranimin e kërkesëpadisë së Kurum International për ndryshimin e vendimeve në njoftim vlerësimin Nr. 11602/52 dhe 89/9 të TVSH-së për vitin 2011 dhe 2012. Shoqëria është njoftuar në datë 28.02.2018 nga Drejtoria e Kontrollit Tatimore se në zbatim të vendimit të sipërcituar dhe pas rivolesimeve të kryera për vlerat e raportuara në njoftimin e vlerësimeve tatimore Nr. 11602/52 dhe 89/9, vlera totale e TVSH për tu rimbursuar është në vlerën 231,582,007 lekë. Në bazë të të njëjtët vendim, shoqëria ka njojur edhe rimbursim për gjobat lidhur me TVSH dhe Tatim fitimin gjatë viteve 2011-2013, te cilat janë falur dhe pjesa e paguar nga shoqëria deri në daljen e këtij vendimi, është kredituar.

Shoqëria, në datë 28.02.2018 ka marrë shkresën 1767/03 nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për rivolesimin e deklaratave të TVSH për shumen 231,582,007 lekë, sipas njoftim vlerësimeve nr. 11602/52 dhe 89/9. Kjo shumë është përfshire në TVSH e arkëtueshme.

15. Të drejta nga palët e lidhura, neto

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të arkëtueshme nga aksionarët	132,950,000	135,230,000
Hua dhe paradhënie me palët e lidhura	239,233,033	520,009,750
Totali	372,183,033	655,239,750

Huatë dhe paradhënie me palët e lidhura nuk mbartin interes dhe nuk kanë afat maturimi.

16. Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të arkëtueshme tregtare	8,443,618,087	7,993,722,370
Të arkëtueshme të tjera	150,926,996	133,306,841
Totali	8,594,545,083	8,127,029,211
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(84,119,267)	(19,191,937)
Totali	8,510,425,816	8,107,837,274

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të arkëtueshme tregtare me të vjetra se një vit	2,069,376,108	447,612,710
Të arkëtueshme tregtare më pak se një vit	6,441,049,708	7,660,224,564
Total	8,510,425,816	8,107,837,274

17. Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjete monetare në bankë	106,763,015	371,680,362
Mjete monetare në arkë	2,920,701	420,435
Total	109,683,716	372,100,797

Mjete monetare në bankë përfshijnë llogari trjedhëse prane bankave të nivelit te dytë ne monedha Lek, Eur, USD dhe CHF, dhe nuk mbartin interes. Shoqëria zoteron gjithashtu fonde të bllokuara në vleren prej prej 175,907,226 lekë (2016 -15,322,946 lekë) pranë Bankës Kombëtare Tregtare, prej të cilave 158,654,280 lekë janë të vendosura në sekuestro preventive nga Autoritetet Tatimore. (shënim 12). Bazuar në Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 30 qershor 2016 “Për miratimin e planit të riorganizimit”, tepricat e flukseve monetare që eventualisht do të rezultojnë në fund të çdo viti financiar në një vlerë më të madhe se 1 milionë euro do të shpërndahen në mënyrë “pro-rata”, duke i dhënë përparrësi kreditorëve të siguruar, kundrejt mosaplikimit të penaliteve të parapagimit nga kreditorët nga pagesa më të hershme.

18. Kapitali

18.1 Kapitali i paguar

Numri total i aksioneve të zakonshme më 31 dhjetor 2017 ishte 6,864,800 aksione (2016: 6,864,800 aksione) me vlerë nominale 1,000 Lekë për aksion. Të gjitha aksionet e emetuara janë plotësisht të paguara.

18.2 Rezerva ligjore

Rezervat ligjore në shumën e 236,832,376 Lekë (2016: 236,832,376 Lekë) përfaqësojnë përvetësimin e një pjese të fitimeve të mbartura në përputhje me Ligjin nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” datë 14 prill 2008, i cili kërkon që të paktën 5% e fitimit, por jo më shumë se 10% e kapitalit të nënshkruar të mbahet si rezervë ligjore. Më 31 dhjetor 2017, rezervat ligjore përfaqësojnë 3.44% të kapitalit të nënshkruar të Shoqërise (2016: 3.44%).

18.4 Rezerva të tjera

Më 31 dhjetor 2017, rezerva të tjera arrijnë shumën 2,332,441,009 Lekë (2016: 2,332,441,009 Lekë) dhe përfaqësojnë transferimin e fitimeve të akumuluara sipas vendimeve përkatëse nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit të vetëm.

19. Huatë

Huate sipas maturitetit analizohen si me poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Huatë afatgjata		
Hua afatgjatë nga bankat	25,821,153,741	20,956,541,077
Huatë afatshkurtra		
Hua afatshkurtër nga bankat	3,159,551,588	8,801,383,865
Totali	28,980,705,329	29,757,924,942

Huatë sipas monedhës analizohen si me poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Huatë		
Në Lek	1,173,397,633	2,252,708,960
Në Euro	24,115,262,758	22,799,538,211
Në USD	3,692,044,938	4,705,677,770
Totali	28,980,705,329	29,757,924,941

19. Huatë (vazhdim)

Bazuar në Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 30 qershor 2016 “Për miratimin e planit të riorganizimit”, kërkesat e kreditorëve janë pranuar. Sipas planit, huatë e Shoqërisë ndaj kreditorëve të siguruar do të mbartin një normë interesë prej 5.3%, respektivisht për huatë ndaj International Financial Corporation (“IFC”), të tipit sindikatë (kredi ndaj Bankës Kombëtare Tregtare (“BKT”) dhe Raiffesisen Bank), dhe 5.1% ndaj Black Sea Trading and Development Bank.

Kredite pas miratimit të planit të riorganizimit sipas llojit te kreditorëve analizohen si më poshtë:

		31 dhjetor 2017
Huatë		
Kreditore të siguruar		11,102,025,184
Kreditore të pasiguruar		17,229,352,741
Interesa te përllogaritura		649,327,404
Total		28,980,705,329

20. Të pagueshme tregtare dhe të tjera

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kurum Demir San VE AS	7,025,950,097	7,146,440,253
Albametal Sh.p.k	2,840,194,904	2,900,902,959
Vosmet Limited	769,125,056	-
Kurum Holding	118,294,800	120,323,473
Të pagueshme tregtare të tjera	716,748,049	696,805,149
Totali	11,470,312,906	10,864,471,834

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, të pagueshmet tregtare përfshijnë shumat e pagueshme për blerjen e lëndëve të para.

21. Detyrime qiraje financiare

Gjate vitit 2017, Shoqëria ka shlyer detyrimin për qiranë financiare të marrë nga banka turke Garanti Finansal Kiralama A.Ş. në monedhën dollarë amerikan, në datë 20 nëntor 2013. Qiraja financiare analizohet si vijon:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Vlera më 1 janar	21,780,412	70,261,847
Qira financiare gjatë vitit	-	-
Paguar gjatë vitit	(21,780,412)	(48,481,435)
Vlera më 31 dhjetor	-	21,780,412

	Minimumi i pagesave të qerasë 2017	Vlera aktuale e minimumit të pagesave të qerasë 2017	Minimumi i pagesave të qerasë 2016	Vlera aktuale e minimumit të pagesave të qerasë 2016
			2017	2016
Jo me shume se një vit	-	-	24,841,787	21,780,412
Te ardhura të pritshme nga interesi	-	-	(3,061,375)	-
Investimi neto ne qera financiare	-	-	21,780,412	21,780,412

22. Dividend i pagueshëm

Dividend i pagueshëm përfaqëson detyrimin e mbartur për shpërndarjen e rezultatit të vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2012, ndaj ish aksionarëve të Shoqërisë, buxhetit te shtetit, Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energitikës sipas vendimit nr. 2545 datë 20 maj 2013.

23. Detyrime të tjera

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrime ndaj personelit	33,663,492	27,878,603
Detyrime ndaj shtetit	19,520,540	11,263,343
Arkëtim në avance nga Energjia Doo Veternik	95,271,537	-
Debitorë kreditorë të tjerë ERE	11,542,218	-
Të tjera	2,048,708	2,297,307
Total	162,046,495	41,439,253

24. Të ardhura nga shitja

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shitia e mallrave	18,244,513,793	10,482,855,563
Energji elektrike	1,475,517,015	1,680,985,768
Të tjera	154,643,743	49,522,361
Totali	19,874,674,551	12,213,363,692

Më 30 qershor 2016, Shoqëria kaloi në riorganizim (shih shënimin 1), i cili kontribuoit në uljen e të ardhurave gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016. Gjatë vitit 2017, Shoqëria ka tritur të ardhurat nga shitja e mallrave, kryesisht nga shitja e hekurit në konsumatorët lokalë.

25. Të ardhura të tjera operative

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhura nga mbetjet teknologjike	139,461,152	-
Të ardhura nga mbyllja e llogarive me furnitore dhe klientë	-	120,292,299
Të tjera	29,606,443	23,799,076
Totali	169,067,595	144,091,375

Të ardhura nga mbyllja e llogarive me furniture dhe klientë ne vitin 2016 perfaqëson diferençat e lindura nga akt-rakordimet e Shoqërisë me furnitoret dhe klientet me 31 dhjetor 2016.

26. Materiale të para dhe të konsumueshme

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Lëndë e parë dhe mallra të konsumueshme	12,568,133,472	7,909,876,875
Materiale ndihmëse	2,451,569,021	884,311,916
Transport	156,040,420	85,352,538
Totali	15,175,742,913	8,879,541,329

27. Shpenzime personeli

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime për pagë	436,275,859	308,684,242
Shpenzime të tjera	67,649,513	96,017,076
Kontributë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	69,361,816	48,122,662
Total	573,287,188	452,823,980

28. Shpenzime të tjera

Shpenzimet sipas kategorive përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Energji, avuj dhe oksigjen	1,682,024,203	517,868,214
Shpenzime nentrajtime te per gjithshme	160,251,509	93,821,004
Shpenzime për zhvlerësim të arkëtueshmeve tregtare	64,927,330	-
Taksa dhe tarifa	34,504,067	23,779,006
Gjoba dhe penalitet	49,006,016	51,096,769
Shpenzime mirëmbajtje dhe riparimi	36,822,003	15,700,219
Primi i sigurimeve	18,105,683	28,786,971
Shpenzime doganore	17,029,464	10,164,692
Shpenzime transporti	7,228,550	2,784,718
Shpenzime telefoni dhe poste	5,883,471	7,151,328
Shpenzime qiraje	4,596,304	2,171,978
Shpenzime marketing	125,750	1,706,525
Shpenzime përfaqësimi dhe udhëtimi	2,315,486	741,592
Shpenzime operative ne HEC-e	30,456,833	31,036,942
Të tjera	53,000,337	64,298,211
Totali	2,166,277,006	851,108,169

29. Shpenzime financiare, neto

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime interesë nga huatë	1,414,378,996	873,941,537
Humbje/(fitim) neto nga kursi i këmbimit	(846,737,417)	(580,450,272)
Totali	567,641,579	293,491,265

Në shpenzime interesë nga huatë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë përfshirë interesat e përllogaritura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 në vlerën prej 400,097,049 lekë bazuar në Vendimin e Gjykatës së Rethit Gjyqësor Tiranë, datë 30 qershor 2016 “Për miratimin e planit të riorganizimit”.

30. Tatimi mbi fitimin

Shoqëria e përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Në vitin 2017 norma e tatimit mbi fitimin është 15% (2016:15%) e të ardhurës së tatushme.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Gjendja në 1 janar	624,936,587	624,946,587
Tatimi mbi fitimin per vitin	-	-
Tatimi fitimi i paguar	-	-
Gjendja në 31 dhjetor	624,936,587	624,946,587

Në vijim jepet një rakkordim i tatimit mbi fitimin i përllogaritur në bazë të normës së tatimit të aplikueshme ndaj shpenzimit të tativit fitimi.

	Norma	2017	Norma	2016
Fitimi/(humbja) e vitit		364,879,950	(495,346,425)	
Tatimi i përllogaritur me normën e aplikueshme	15%	54,731,993	15%	(74,301,964)
Shpenzime të pazbritshme	5%	17,090,002	2%	7,664,545
Fitimi jo i tatushëm	-1%	(3,569,313)	1%	(348,842)
Humbje tatimore e panjohur	-19%	(68,252,682)	-14%	66,986,261
Tatimi mbi fitimin	0%	-	0%	-

Humjet tatimore të mbartuara nga viti 2016 janë 363,540,031 leke janë (2015 - 527,828,001 leke).

Periudha e mbartjes së humbjes fiskale në përputhje me ligjet në Shqipëri është tre vjet.

Shoqëria nuk ka njojur aktive tatimore të shtyra për humbje tatimore, sepse nuk pritet të ketë fitime të ardhshme të tatushme në dispozicion kundrejt të cilave filialet të mund të përdorin humjet e mbartura tatimore.

Eksposimet fiskale

Në përcaktimin e vlerës së tativit aktual Shoqëria merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse taksa dhe interesa të tjera mund të jenë të detyrueshme. Shoqëria beson se përllogaritjet e detyrimeve tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet e hapura fiskale bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, përfshire interpretimin e ligjt mbi tativit dhe eksperiencat e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në çmuarje dhe supozime dhe mund të përfshijnë një seri gjykimesh për ngjarjet e ardhshme. Shoqëria mund të ndryshojë gjykim bazuar në informacionin e ri të disponueshëm, lidhur me mjaftueshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime ndaj detyrimeve tatimore do të ndikojnë shpenzimin tatimor gjatë periudhës në të cilën ky përcaktim bëhet.

31. Palët e lidhura

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të drejta nga palët e lidhura		
Albania Oil Refinery	162,200,992	158,391,336
Kurum Industrial Gases Sh.a.	66,811,751	104,165,106
Konti Steel Dooel	-	328,721,069
Durres Logistic Center sh.a	13,632,896	13,112,896
Të pagueshme ndaj aksionerëve	132,950,000	135,230,000
Totali	375,595,639	739,620,407
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Kurum Industrial Gases Sh.a.	(3,412,606)	-
Konti Steel Dooel	-	(84,380,657)
Totali	(3,412,606)	(84,380,657)
Të drejta nga palët e lidhura, neto	372,183,033	655,239,750
<i>Investime</i>		
Kurum Industrial Gases Sh.a.	2,000,000	2,000,000
Illyria Resources and Metallurgy Sh.a.	800,000	800,000
Albania Oil Refinery	3,500,000	3,500,000
Durres Logistic Center Sh.a.	3,500,000	3,500,000
Totali	9,800,000	9,800,000
 <i>Shitje mallrash</i>		
Kurum Industrial Gases Sh.a.	196,301,758	75,753,012
Konti Steel Dooel	-	281,414,291
Totali	196,301,758	357,167,303
 <i>Blerje e mallrave</i>		
Kurum Industrial Gases Sh.a.	286,841,418	95,767,632
Konti Steel Dooel	-	52,308,781
Totali të pagueshme ndaj palëve të lidhura	286,841,418	148,076,413
 <i>Huatë e transferuara nga Shoqëria</i>		
Albania Oil Refinery Sh.a.	3,809,656	2,507,167
Durres Logistic Center Sh.a.	520,000	1,642,699
Totali	4,329,656	4,149,866

Më 31 dhjetor 2017, shuma e arkëtuar nga Konti Steel Dooel është 456,023,728 Lekë (2016: 328,721,069 Lekë). Shoqëria ka zotuar 50% te aksioneve të Konti Steel Dooel ne vlore nominale 2,500 Euro, deri me 31 mars 2016. Me pas Shoqëria shiti aksionet e zotëruara në Konti Steel Dooel, dhe balancat me Konti Steel Dooel në vitin 2017 janë të përfshira ne të pagueshme tregtare dhe të tjera.

Shpërbimi i Drejtuesve kryesorë

Shpërbimi i Drejtuesve kryesorë më 31 dhjetor 2017 është 12,730,373 Lekë (2016: 13,247,040 Lekë).

32. Angazhime kapitale dhe detyrime të mundshme

Procedurat ligjore dhe tatimore

Shoqëria është e perfshire në çështje gjyqësore të ngritura për pretendime në vleren 7,931,895 mijë lekë. Shoqeria ka njohur si detyrime vleren prej 7,651,087 mijë lekë. Për pjesën e mbetur të pretendimeve në vlerën 390,685 mijë leke, drejtimi i Shoqërisë është i mendimit se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet e tjera ligjore të pazgjidhura më 31 dhjetor 2017.

Përveç kësaj, librat dhe regjistrimet tatimore të Shoqërisë janë inspektuar nga autoritetet tatimore vendore deri në muajin qershor 2018. Në datë 18 dhjetor 2018, Shoqëria ka marrë njoftimin se detyrimet për gjoba dhe penalitete deri në muajin qershor 2018 llogariten në vlerën 441,484,887 lekë.

Taksat shtesë që mund të lindin në rast të auditimit tatimor nuk mund të përcaktohen me ndonjë saktësi të arsyeshme.

Angazhime kapitale

Shoqëria nuk ka hyrë në zotimet kapitale më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

33. Ngjarjet pas datës së raportimit

Gjykata e rrëthit Gjyqësor Tiranë më anë të vendimit numër 10234 datë 11.12.2018 vendosi, miratimin dhe aprovimin e veprimitarise se administratorit të shoqërisë z. SERVET SAKIR KURUM, që nga momenti i emërimit te tij me Vendimin e Asamblee së Përgjithshme të datës 31.10.2017 për të vepruar në një mandat 3 (tre) vjecar. Statusi i shoqërisë ishte ("Shoqëri në procedurë falimenti") u be ("Aktiv"). Administrator i shoqerise eshte vetem z Servet Sakir Kurum. Ai perfaqeson Shoqerinë me të tretët, ndërsa znj. Lindita Kikino (administratore falimenti) vetem do të mbikqyrë në perputhje me percaktimet e planit te riorganizimit dhe dispozitat ligjore permbushjen e pretendimeve te kreditoreve sipas planit te riorganizimit.

Nuk ka pasur asnjë ngjarje tjeter pas datës së raportimit, e cila kërkon ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare.